

## Mendime te mira

Emetimi i mendimeve te mira nga dishepujt e Dafes ne kete periudhe te veçante historike me qellim per te kufizuar persekutimin e qenieve te keqija ndaj Dafes, dishepujve te Dafes dhe njerezve ne bote, ka luajtur nje rol shume kritik. Nje numer i madh qeniesh te keqija jane spastruar ne kohe e duhur para se te arrije forca e Korigjimit te Ligjit dhe kjo ka zvogeluar shume humbje te mundshme. Megjithate qeniet e keqija e kane pare tashme qe jane te destinuara te humbin, dhe ato po veprojne gjithnje e me shume çmenduri. Dishepujt e Dafes jane tani shpresa e vetme per shpetim per qeniet e gjalla. Keshtu, me qellim qe te kryejme Korigjimin e Ligjit me me efektivitet, ndersa ju shpjegoni faktet (e persekutimit) ju duhet ta konsideroni emetimin e mendimeve te drejta shume seriozisht dhe spastroni te keqen ne kohen e duhur si dhe problemet tuaja qe te mos i jepni shkas te keqes te nderhyje. Ne kete kohe ka akoma nxenes te cilet nuk i kane kuptuar pikat themelore te emetimit te mendimeve te mira. Disa nxenes jane plotesisht ne gjendjen e njejte si kur bejne meditimin, bile dhe kur kryejne meditimin, disa nxenes jane ne gjendje gysem te fjetur, jane ne nje gjendje ku mendjet e tyre nuk jane shume te vetedijshme, apo jane ne nje gjendje ku mendime te çrregullta i nderhyjne seriozisht, keshtuqë ata nuk arrijne te kene rezultat te mire. Ka gjithashtu disa nxenes qe kur emetojne mendime te mira me qellim piketojne ne mendje nje apo disa elemente te keqinj dhe kjo i pengon *gongun* dhe fuqite hyjnore qe ata leshojne qe te mos kene efektin maksimal. Sigurisht, neqoftese kushtet jane te atilla dhe ju piketoni nje apo disa qenie te keqija ndersa ju emetoni mendime te mira, vetem ose ne grup, atehere ju mund ta beni kete dhe fuqia e perqendruar eshte e jashtezakonshme. Por kur ju emetoni mendime te mira normalisht se bashku çdo dite ju duhet te perndiqni te keqen ne shkalle me te gjere. Ju nuk duhet te fokusoheni tek nje apo disa qenie te keqija çdo dite apo çdo here.

Kjo eshte menyra si ta beni: (1) Ju duhet te fokusoni vemendjen dhe perpjekjen, mendja juaj duhet te jete absolutisht e kthjellet dhe racionale, forca e mendimeve tuaja duhet te jete e perqendruar dhe e forte, me nje ndjenje superioriteti dhe te shkaterrimit te gjithë te keqes ne kozmos. (2) Dishepujt qe ne kete kohe nuk mund te shohin dimensionet e tjera mund te perqendrojne mendime te fuqishme duke thene fjalen *Mie*<sup>1</sup> (灭) pasi te mbarojne se theni formulat. Fjala *Mie* (灭) duhet te jete aq e forte sa te jete e madhe aq sa dhe trupi kozmik, duke perfshire çdo gje dhe mos duke lene asgje jashte ne asnje dimension. (3) Ata dishepuj qe mund te

---

<sup>1</sup> Kjo eshte fjala e fundit ne nje nga formulat dhe do te thote “spastruar”, “eliminuar”, “qeruar”, etj. Shqiptohet “mjeh”.

shikojne qeniet e keqija ne dimensione te tjera mund ti bejne gjerat sipas situatave qe jane te vetedijshem. Mendimet e tyre te mira duhet te jene te fuqishme dhe ata duhet te perdorin mençurine e tyre te plote. Nje mendim i mire mund njeqind gjera te keqija. (4) Me sy mbydhur apo sy hapur efekti eshte i njejte kur you emetoni mendime te mira. Nese i mban syte hapur ti duhet te arrish nje gjendje ku nuk ve re asgje qe shikon ne kete dimension njerezor.

Kur ti emeton mendime te mira, pamvaresisht sa intensive qe behen gjerat, ne siperfaqe qendro i qete. Kjo sidomos duhet te jete keshtu kur je ne pune apo ne ndonje vend tjeter; ti nuk ke nevoje te ngrësh pëllemben dhe rezultati do jete i njejte. Per sa kohe qe i mban mendimet e mira te forta dhe perqendron mendjen ti mund te arrish te njejtin rezultat. Por ne kushte normale ju duhet te mbani pëllemben te ngritur ose ne pozicion lotus.

Me qellim qe te zvogelojme humbjet dhe te shpetojme qeniet e gjalla, verini mendimet e mira te fuqishme prej dishepulli te Dafes ne perdorim te plote! Demonstroni Virtutin tuaj te Plotefuqishem!

Li Hongzhi

13 Tetor 2002